

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtari Naser Foniqi - kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët Violeta Namani dhe Vehbi Kashtanjeva, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Rilinda Kadriu, si procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit R.J, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të KPK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut - tani Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.669-4/2011, të datës 26.01.2012, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 27.04.2018, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Besa Limani dhe i akuzuari R.J, pas shqyrtimit gjyqësor, të njëjtën ditë, me datë 27.04.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari R.J, i biri i G. dhe F, e vajzërisë H, i lindur me ..., në fshatin B, Komuna P, ku edhe jeton, me numër personal ..., i martuar- baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e: deri me datë 19.08.2011, rreth orës 11:47, në shtëpinë e tij në fshatin B, Komuna P, pa leje për mbajtjen e autorizuar të armëve, ka mbajtur në pronësi pushkën automatike me numër serik 8-56742, prodhim jugosllav, së bashku me dy karikatorë dhe 51 fishekë, të kalibrit 7.62 x 39 mm, me të cilën në oborrin e shtëpisë së tij, i është kërcënuar tani të dëmtuarit A.J, në atë kohë 14 vjeç, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ka qenë duke u kthyer nga varrezat e fshatit të cilat gjenden pranë shtëpisë së të pandehurit, i njëjti me qëllim që ta frikësoj të dëmtuarin, ka nxjerrë nga trupi - nënbluza pushkën automatike, e ka repetuar dhe të dëmtuarin e ka kanosur dhe fyer me fjalë banale, me ç rast i dëmtuari nga frika është alivanosur, ndërsa pas kontrollimit të shtëpisë së tani të akuzuarit nga policia, atij i janë sekuestruar pushka automatike, dy karikatorët dhe fishekët të cekur si më lart, të cilat i kishte hedhur prapa shtëpisë, nga dritarja e banjës,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të Kodit Penal të Kosovës.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 34; 41; 42; 43; 44; 64 dhe 328, par. 1 dhe 5 të KPK, si dhe nenit 365, të KPP, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM BURGIMI ME KUSHT

- **Në kohëzgjatje prej një (1) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) vite, në qoftë se i pandehuri R.J, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **tridhjetë (30.00) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarit, i konfiskohet arma – pushka automatike me numër serik 8-56742 – prodhim jugosllav, dy karikatorë dhe 51 fishekë, të kalibrit 7.62 x 39 mm, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale.
- **I dëmtuari A (I) J**, nga fshati B, Komuna P, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Prokuroria e Qarkut - tani Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.669-4/2011, të datës 26.01.2012, e ka akuzuar R.J, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të KPK.

Pasi që në çështjen penale konkrete është konfirmuar aktakuza, me aktvendimin KA.nr.60/12, të datës 06.11.2012, në këtë rast gjykata ka proceduar direkt me shqyrtim gjyqësor.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 27.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari R.J, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërsa në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që ta falë në këtë rast, duke shtuar se nëse gjykata e shpall fajtorë, atij t'i shqiptoj një dënim me të butë dhe te ketë parasysh gjendjen e tij ekonomike, me arsyetim se në familjen e tij nuk punon askush, si dhe ka kërkuar nga gjykata ta ketë parasysh se me të dëmtuarin janë pajtuar.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i pandehuri, Prokurorja e Shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, **pasi ky pranim është bërë me vullnetin e tij të plotë duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë**, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, konsideron se në mënyrë të plotë është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet dhe kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe sot me vet pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e i cili pranim është në përputhshmëri të plotë me faktet dhe provat e propozuar në aktakuzë, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtorë dhe ta dënoi sipas ligjit si dhe gjatë shqyrtimit të sanksionit penal si rrethanë lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria, trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari Rafet Jashari, pasi është bindur se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se ky pranim u bë vullnetarisht dhe është mbështet në provat që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të KPK, si

dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale të kryer; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë gjykimit; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; sjellja e mëparshme e të akuzuarit, duke pasur parasysh se për të akuzuarin sipas të dhënave penale të kësaj gjykate – DKR, nuk ka prova se i njëjti ka qenë i dënuar më parë apo ndaj tij është ngritur ndonjë aktakuzë dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për këtë veprë penale, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34, të KPK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohet arma e përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 328, par. 5, të KPK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë **27.04.2018**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
P.nr.745/12, datë 27.04.2018

Sekretare juridike,
Rilinda Kadriu

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.